

MEMORANDUM MIREKUPITIMI MIDIS QEVERISE SE REPUBLIKES  
SE SHQIPERISE DHE QEVERISE TE SHTETIT TE IZRAELIT  
PER VENDOSJEN E MARREDHENIEVE DIPLOMATIKE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit, si rezultat i bisedimeve të bera midis përfaqësuesve të tyre, vendosen marrëdhënie diplomatike duke filluar nga kjo datë dhe u moren vesh për sa më poshtë:

Neni 1

1. Të dy qeveritë do të japin gjithë ndihmen e nevojshme për hapjen sa më shpejt që të jetë e mundur të misionëve diplomatike që të kryejnë funksionet e tyre, duke përfshirë ato konsulllore, në përputhje me Konventën e Vjenës për marrëdhënie diplomatike, të 18 prillit 1961 dhe në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit prites.

2. Qeveritë afirmojnë qëllimin e tyre që t'u përmbahen parimeve themelore, duke përfshirë parimin e paprekshmërisë të selive të misionëve diplomatike, mbi të cilat bazohen shkëmbimet diplomatike.

Neni 2

Të dy qeveritë do të nxisin marrëdhëniet në fushat ekonomike, shkencore, teknike, dhe kulturore, si dhe në fusha të tjera